



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:226648
Datë: 30.09.2024
Numri i dokumentit: 06226492

C-IV.-13-1197

Ankuesi

Z A, Novi Beograd, Serbia.

Përfaqësuar nga N T dhe G M, Projekti për Ndihmë Juridike Falas, Graçanica.

Kundër

E paditura

DP “Autoshtëpia,, M R” (në likuidim), e përfaqësuar nga
Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. “Driton Hoxha”, nr. 55, Lakërishtë- Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), me gjyqtaren Ganimete Puka, me 30.shtator.2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e ankuesit Z A dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI070-0468, dt.30.maj.2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. **Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 06 shkurt 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankese ndaj Vendimit nr. GJI070-0468, dt.30.maj.2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar që ti kompensohen pagat e papaguara, për periudhën qershor 1999 - prill 2007, në shumën prej 14.100.00€, nga NSH “Autoshtëpia,, Mustafë Rexhepi”. Ankuesi pohon së vendimin e AL-së, është i pa ligjshëm për shkak të vërtetimit të pamjaftueshëm të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Po ashtu ankuesi pohoi se, refuzimi i kërkesës së tij, për shkak të parashkrimit të kërkesës, ka cenuar rëndë parimet themelor të sigurisë juridike dhe shkelur nenin 6 të, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe vendimi i kundërshtuar është i pa qartë dhe nuk përmban arsye, pra ekzistojnë kritere dhe prova për zgjidhjen e këtij kontesti nga marrëdhënia e punës.

Ankuesi tutje pohon së atij nuk i ka përfunduar zyrtarisht-juridikisht marrëdhënia e punës nga punëdhënësi, mirëpo për shkak të rrethanave diskriminuese në baza etnike objektivisht ka qenë i penguar të vazhdon që të punonte . Tutje, ankuesi ka pohuar se si pjesëtar i komunitetit Rom në Kosovës, për shkak të rrethanave të njohur është detyruar të largohet nga Ferizaj në qershor të vitit 1999, dhe i njëjti është larguar nga vendi i punës për shkak të sigurisë, pastaj është rikthyer sipas një marrëveshjes për rikthimin e refugjateve. Tutje ankuesi, pohon së thirrja e AKP/së se kërkesa e tij është e parashkruar është trajtim i pa barabartë , dhe sipas nenin 8 të Ligjit kundër diskriminimit, ankuesi është diskriminuar sepse në raste të ngjashme me kërkesat të njëjta, ndaj shqiptareve AL ka vendosur pozitivisht duke u thirr se ka pas diskriminim , ndërsa për rastin e tij AL e refuzon për shkak të parashkrimit. Ankuesi pohon, së këto fakte vërtetohen edhe me aktgjykim të Dhomës së Posaçme të Supremes, për këtë çështje SCEL-09-0007, datë 16.12.2010. Ankuesi i propozon Gjykatës, që ankesën e tij ta aprovoj si të bazuar.

Me 21.nëntor.2013, ankuesi ka pranuar urdhrin e gjykatës, të njëjtit ju është kërkuar që të dorëzoj autorizoj avokat për përfaqësim, vendimin e kundërshtuar, të dorëzoj prova në mbështetje të ankesës së tij, si dhe ankesën të dorëzoj të përkthyer në gjuhën angleze, si dhe i njëjti është paralajmëruar për pasojat ligjore nëse nuk vepron komfor urdhrin të gjykatës.

Me 26.dhjetor. 2013, ankuesi përmes parashtresës, dorëzon autorizimin për përfaqësim si dhe vendimin e kundërshtuar të AL, si dhe ka kërkuar lirim nga përkthimi, duke dorëzuar edhe prova, të cila gjenden në shkresat e lëndës..

Me 25.nëntor.2016, e paditura parashtroi mbrojtjen në ankesë, në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit. Po ashtu e paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është e parashkruar në pajtim me nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Ankuesi kërkon paga të papaguara për periudhën qershor.1999 - prill.2007, në shumën prej 14.100.00 €. E paditura pohoi se nuk ka prova që ankuesi e ka dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent brenda periudhës tre vjeçare të parashkrimit, pra qershor. 2002. AKP pohoi se ankuesi nuk ka prezantuar fakte edhe në kuptim të nenit 7 të Ligjit mbi procedurën kontestimore ku theksohet se “palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së.

Me 20.dhjetor.2016, i autorizuari i ankuesit, dorëzoj përgjigje ndaj mbrojtës së AKP, me të cilën e kundërshton në tersi pretendimet e të paditurës, duke mbetur në tersi pranë pretendimeve dhe propozimeve si në ankesë.

Me 06.janar 2017, AKP, në kundërpërgjigje mbete në tersi pranë kundërshtimeve dhe propozimit si dhënë sikur në mbrojtje.

Në lidhje me detajet tjera, gjykata i referohet shkresave të lëndës dhe parashtresave të palëve.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton se si në vijim: Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti së ankuesi ishte një punëtorë e NSH “ DP Autoshtëpia,, Mustafë Rexhepi”, këtë nuk e ka mohuar e paditura. Si dhe nuk ishte kontestues në mes të palëve së ankuesi nuk ka punuar për NSH, pas vitit 1999, dhe këtë nuk e ka mohuar ankuesi.

Gjykata gjënë si kontestuese në mes të palëve , së ankesa e ankuesit ka apo nuk ka bazë ligjor për aprovim.

Gjykata gjënë së Ankuesi kërkon kompensimin e pagave të pa paguara nga qershori i vitit 1999-deri në prill të vitit 2007, në shumën prej 14.100.00€, ndërsa e paditura e konteston një kërkesë të tillë, me pretendimin së kërkesa e ankuesit është e parashikuar si dhe ankuesi nuk ka puna pas vitin 1999, dhe një e drejt e tillë nuk i takon.

Ankuesi, pretendon së për shkak të rrethanave të njohura si komunitet rom për shkaqe të sigurisë është detyruar të largohet nga Ferizaj, në qershor të vitit 1999, dhe nuk ka pas mundësi që të punon, mirëpo sipas ankuesit për raste të njëjta ndaj shqiptareve AKP, ka vendos pozitivisht dhe nuk është thirr në parashikim, ndërsa ndaj tij si entitet Rom, AKP po thirret në parashikim dhe sipas ankuesit për shkak të situatës së tij të ditur botërisht parashikim nuk mund të ec dhe ndërprite përshkrimi, dhe AKP, ka përdor standard të dy fish edhe i njëjti është diskriminua, me rastin e refuzimit të kërkesës së tij, për shkak të parashkrimit.

Gjykata nuk u lëshuar në arsyeshmërinë e këtij pretendimi se kërkesa e ankuesit është apo nuk është e parashkruar, për faktin së kjo pjesë është e rregulluar edhe me dispozitat ligjore që kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës, (neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76), si dhe nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së, si dhe nenin 87, i Ligjit të Punës në Kosovës).

Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet që kanë qenë të aplikuara në atë kohë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se ankuesi kërkesën për pagat e pa paguara e ka parashtruar pranë Autoritetit të Likuidimit, më 11.prill. 2006, brenda afatit për parashtrimin e kërkesave pranë AL-së, por që në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, një kërkesë e tillë në atë kohë vetëm së ishte parashkruar.

Gjykata ka vlerësuar dhe ka analizuar pretendimin e ankuesit së i njëjti është diskriminuar, me pretendimin së AKP, për raste të njëjta ka përdor standard të dy fish , për shqiptaret është thirr në diskriminim dhe ka vendosur pozitivisht në raport me ta, ndërsa atij ju është refuzuar kërkesa e tij, për shkak të parashkrimit.

Gjykata pa u lëshuar në vlerësimin e pretendimit të ankuesit së është i diskriminuar , nxjerr këtë përfundim së kërkesa e ankuesit nuk ka bazë ligjore për aprovim.

Për gjykatën janë të pa pranueshëm pretendimet e ankuesit, për faktin së si me ligjet vendore dhe ndërkombëtare , decidivish përcaktohet së çdo i punësuar gëzon të drejtën për kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera shtesë, për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, (nenin 55.2, i Ligjit të Punës në Kosovës), në rastin konkret nuk është kontestuese fakti së ankuesi nuk ka ofruar shërbime punë pas muaji qershor 1999 , dhe një e drejt e tillë nuk gëzon mbrojtje ligjor, për arsyet e larte cituara punëtori gëzon të drejtën për kompensimin në pagë vetëm për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, e jo siç pretendon ankuesi në ankesën e tij, për çka edhe vendimi i kundërshtuar është i drejte dhe i ligjshëm.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet të tjera të ankuesit, mirëpo ka ardhur në përfundim se në bazë të provave dhe arsyeve të elaboruara si me lartë nuk ka vend për të nxjerrë një vendim më ndryshe.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë i bart shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Ganimete Puka

G j y q t a r e